



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 27

Tiranë – E martë, 13 shkurt 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 57, datë 7.2.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 199, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në Këshillin Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar..... 2719
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 7.2.2024	Për ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si autoritet kontraktor, për realizimin e projektit të shtesës së godinës “Poli i Drejtësisë”, në funksion të Shkollës së Magjistraturës..... 2719
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 60, datë 7.2.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 314, datë 11.5.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, funksionimin, përbërjen, kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes, si dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të <i>Start Up</i> -eve” 2719
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 61, datë 7.2.2024	Për miratimin e kërkesave e të kriterëve që duhet të plotësojnë <i>start up</i> -et dhe lehtësuesit e <i>start up</i> -eve, të procedurave e të afateve, si dhe të rregullave për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe ankimit, kriterëve, procedurës së përzgjedhjes e të shpërblimit të anëtarëve të tyre..... 2721
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 1.2.2024	Për miratimin e rregullores teknike mbi standardet për trajtimin e ujërave të ndotura për subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotura dhe të patrajuara pranë ose në ujëra larëse..... 2725
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 57/17, datë 13.2.2024	Për disa shtesa në VKM-në nr. 332, datë 31.5.2023, “Për shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i aksit “Thumanë–Vorë–Kashar”, i ndryshuar..... 2734



VENDIM

Nr. 57, datë 7.2.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 199, DATË 10.4.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË KËSHILLIN DREJTUES TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 2, të vendimit nr. 199, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Znj. Elva Margariti, ministër i Kulturës, zëvendësohet me z. Blendi Gonxhja, ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

2. Znj. Delina Ibrahimaj, ministër i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, zëvendësohet me z. Arbjan Mazniku, ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 58, datë 7.2.2024

PËR NGARKIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, SI AUTORITET KONTRAKTOR, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË SHITESËS SË GODINËS “POLI I DREJTËSISË”, NË FUNKSION TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si autoritet kontraktor dhe njësi zbatuese, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik për realizimin e projektit të shtesës së godinës “Poli i Drejtësisë”, në funksion të Shkollës së Magjistraturës.

2. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si autoritet kontraktor dhe njësi zbatuese, sipas pikës 1, ngarkohet të kryejë:

a) të gjitha procedurat, sipas legjislacionit në fuqi, për prokurimin publik, duke lidhur edhe kontratën përkatëse, si dhe të ndjekë zbatimin e saj dhe të projektit përkatës;

b) paraqitjen, në emër dhe për llogari të Shkollës së Magjistraturës, të kërkesave për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe të ndërtimit pranë autoritetit të zhvillimit të territorit, si dhe ndjekjen e të gjitha veprimeve e procedurave të nevojshme për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Këtu përfshihet edhe marrja e miratimeve paraprake apo vijuese nga autoritetet përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Fondi Shqiptar i Zhvillimit i paraqet Ministrisë së Financave kërkesën për të hartuar dhe për të ndërmarrë nismën për alokimin e fondeve të nevojshme për zbatimin e projektit pranë tij.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 60, datë 7.2.2024

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 314, DATË 11.5.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, PËRBËRJEN, KRITERET DHE PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES, SI DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË START UP-eve”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 8, të ligjit nr. 25/2022, “Për



mbështetjen dhe zhvillimin e *start up*-eve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 314, datë 11.5.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, funksionimin, përbërjen, kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes, si dhe shpërbllimin e anëtarëve të Këshillit të *Start Up*-eve”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në titullin e vendimit, pas fjalës “... përbërjen ...” shtohet fjala “... kompetencat ...”;

b) Në pikën 1, të kreut I, pas fjalëve “... përcaktimi i kriterëve ...” shtohet fjala “... kompetencave ...”;

c) Pika 3, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Këshilli i *Start Up*-eve kryesohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë të tjerë nga institucione të lidhura me shërbimet e ofruara për biznesin, *Start Up*-et dhe ekosistemin, me mandat për një periudhë 1-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje, si më poshtë vijon:

a) zëvendësministri i ministrisë përgjegjëse për ekonominë, i cili mbulon fushën e sipërmarrjes;

b) drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI);

c) drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC);

ç) drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës;

d) një anëtar ekspert nga ekosistemi i *start up*-eve;

dh) një anëtar nga komuniteti i donatorëve, që mbulojnë fushën e financimit të *start up*-eve, i caktuar nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen;

e) një anëtar ekspert ndërkombëtar nga fusha e *start up*-eve.”.

ç) Pas pikës 3, të kreut II, shtohen pikat 3/1 dhe 3/2, me këtë përmbajtje:

“3/1. Anëtari ekspert i ekosistemit dhe anëtari ekspert ndërkombëtar nga fusha e *start up*-eve, të parashikuar në shkronjat “d” dhe “e”, të pikës 3, të këtij vendimi, do të përzgjidhen mbi bazën e një procesi transparent konkurrimi, pas shpalljes së thirrjes për ekspertë të publikuar në faqen zyrtare të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen dhe Agjencisë

Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Start Up*-eve dhe Lehtësuesve.

Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Start Up*-eve dhe Lehtësuesve ngarkohet të hartojë termat e referencës, të përcaktojë afatin e aplikimit, si dhe të menaxhojë procesin e konkurrimit e të përzgjedhjes së ekspertëve të parashikuar në shkronjat “d” dhe “e”, të pikës 3, të këtij vendimi.

Ministri përgjegjës për sipërmarrjen shpall fitues aplikantët e vlerësuar me pikët më të larta nga konkurrimi, sipas propozimit të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Start Up*-eve dhe Lehtësuesve.

3/2. Anëtari ekspert i ekosistemit, anëtari ekspert ndërkombëtar nga fusha e *start up*-eve dhe anëtari nga komuniteti i donatorëve, të parashikuar në shkronjat “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 3, të këtij vendimi, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë pune përkatëse në organizma kombëtarë dhe ndërkombëtarë, që kanë për qëllim mbështetjen ndaj *start up*-eve dhe lehtësuesve të ekosistemit;

b) të ketë përvojë në ndërtimin dhe implementimin e strategjive për rritje të kompanive *start up* dhe kërkim-zhvillim shkencor;

c) të ketë përvojë në bashkëpunim ndërkombëtar me ente shtetërore, organizma ndërkombëtarë dhe institucione publike për zhvillimin e politikave ekonomike me fokus sipërmarrjen;

ç) të ketë përvojë si anëtar/kryetar i bordeve të këshillimit në Shqipëri dhe jashtë saj, në institucione financiare dhe organizata zhvillimore ndërkombëtare.”.

d) Pas paragrafit të dytë, të pikës 6, të kreut II, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Në rastin e vakancës së krijuar nga anëtari ekspert i ekosistemit dhe anëtari ekspert ndërkombëtar nga fusha e *start up*-eve, të parashikuar në shkronjat “d” dhe “e”, të pikës 3, të këtij vendimi, ministri përgjegjës për sipërmarrjen, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Start Up*-eve dhe Lehtësuesve, cakton anëtarë të Këshillit aplikantët e renditur të dytët, të parashikuar në pikën 3/1, të këtij vendimi. Në rastin e vakancës së krijuar edhe nga aplikantët e renditur të dytë caktohen si anëtarë aplikantët pasues të renditur.”.



dh) Pika 10, e kreut III, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Këshilli i *Start Up*-eve, për përmbushjen e detyrave dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, mbështetet nga Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Start Up*-eve dhe Lehtësuesve, e cila vepron si sekretariat teknik i Këshillit, nëpërmjet punonjësve të ngarkuar nga drejtori i përgjithshëm.”.

e) Në shkronjën “e”, të pikës 11, të kreut IV, fjalët “... parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 14 ...” zëvendësohen me “... parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 3, të nenit 14 ...”.

ë) Pika 14, e kreut V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“14. Anëtari nga komuniteti i donatorëve, që mbulon fushën e financimit të *start up*-eve përjashtohet nga masa e shpërblimit të parashikuar në pikën 13, të këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Start Up*-eve dhe Lehtësuesve, si dhe institucionet e listuara në pikën 3 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 61, datë 7.2.2024

**PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE E TË
KRITEREVE QË DUHET TË
PLOTËSOJNË *START UP*-et DHE
LEHTËSUESIT E *START UP*-eve, TË
PROCEDURAVE E TË AFATEVE, SI DHE
TË RREGULLAVE PËR PËRBËRJEN E
KOMISIONIT TË VLERËSIMIT DHE
ANKIMIT, KRITEREVE, PROCEDURËS
SË PËRZGJEDHJES E TË SHPËRBLIMIT
TË ANËTARËVE TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 14, të ligjit nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *start up*-eve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i:

a) kërkesave dhe kriterëve që duhet të plotësojnë *start up*-et dhe lehtësuesit e *start up*-eve, procedurave dhe afateve të thirrjes për përfitimin e granteve e të masave mbështetëse;

b) rregullave për ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe të ankimit, kriterëve, procedurave të përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve.

2. Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Start Up*-eve dhe Lehtësuesve (këtu e në vazhdim, e njohur si *Start Up Albania*) i propozon ministrit përgjegjës për sipërmarrjen shpalljen e “Thirrjes për kërkesa për masa mbështetëse”, të shoqëruar me vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

3. *Start Up Albania* harton dhe publikon në faqen e internetit:

a) thirrjen publike për kërkesa për përfitimin e granteve e të masave mbështetëse nga *start up*-et dhe lehtësuesit e *start up*-eve;

b) fondin në dispozicion për çdo thirrje;

c) dokumentacionin për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesave;

ç) formularët e kërkesës;

d) kontratën tip;

dh) udhëzimet e detajuara, të cilat përmbajnë informacion për:

i. mënyrën e shpërndarjes së fondeve dhe zbatimin e projektit;

ii. procedurën e zbatuar;

iii. kriteret minimale të kualifikimit dhe dokumentacionin, që provon plotësimin e tyre;

iv. kushtet e grantit;

v. afatet kohore dhe formalitetet, që duhet të respektohen;

vi. kriteret e përdorura për përzgjedhjen e kandidatëve;

vii. ndarjen e zërave në terma financiarë;

viii. mënyrën e vlerësimit të kërkesave;

ix. detyrimet e raportimit për zbatimin e grantit;

x. mënyrën e kryerjes së monitorimit të projekteve;

e) ndryshimet e kryera dhe sqarimet e bëra përgjatë procedurës;

ë) listën e projektpropozimeve dhe të kandidatëve pjesëmarrës për përfitimin e granteve;



f) vlerësimet përfundimtare të projektpropozimeve, kryer nga komisioni i vlerësimit dhe miratuar nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen.

4. *Start Up Albania* njofton kandidatin pjesëmarrës në procedurat konkurruese për:

a) përzgjedhjen e kërkesës për financim;

b) përzgjedhjen e kushtëzuar të kërkesës për financim dhe kërkesës për rishikim të tij, bazuar në rekomandimet e komisionit;

c) mospërzgjedhjen e kërkesës për financim, arsyetimin e vendimarrjes dhe të drejtën për ankim.

5. *Start Up Albania* kryen procedurën e negocimit me kandidatin e përzgjedhur dhe nënshkruan kontratën e financimit.

6. *Start Up Albania* monitoron zbatimin e projekteve të financuara dhe përgatit vlerësimin e performancës së fondit grant deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj pas përfundimit të implementimit të projektit.

7. Menaxhimi dhe monitorimi i realizimit të granteve financiare të miratuara sipas “Thirrjeve për kërkesa për masa mbështetëse” kryhet nga *Start Up Albania* në bazë të rregullores “Për zbatimin dhe monitorimin e projekteve fituese të thirrjes për masa mbështetëse”, të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen e të publikuar në faqen zyrtare në internet të *Start Up Albania* dhe të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

II. KËRKESAT DHE KRITERET PËR PËRFITIMIN E GRANTIT

1. Mbështetjen me grant e përfitojnë *start up*-et dhe lehtësuesit e *start up*-eve të vetëdeklaruar në regjistrin elektronik të *start up*-eve dhe lehtësuesve, që janë të pajisur me pasaportën përkatëse, sipas nenit 11, të ligjit nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *start up*-eve”, të ndryshuar.

2. Subjektet kërkuese, *start up*, mund të aplikojnë si individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, përfshirë nomadin digjital.

3. Mbështeten me grant *start up*-et që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) Të kenë përfunduar vetëdeklarimin në regjistrin elektronik të *start up*-eve dhe të jenë pajisur me pasaportën e *start up*-it përpara aplikimit;

b) *Start up*-et që përzgjedhin fazën aktuale të zhvillimit të specifikuar nëpërmjet formave të aplikimit:

i. faza fillestare (F1);

ii. faza e validimit (F2);

iii. faza e rritjes (F3);

c) *Start up*-et në fazën fillestare, e hershme, (F1) mund të jenë individë privatë, vendas ose të huaj, përfshirë nomadin digjital, të cilët kanë plan të vijnë në operacionet e biznesit në Shqipëri;

ç) *Start up*-et në fazën e validimit (F2) dhe fazën e rritjes (F3) duhet të jenë biznes i regjistruar ligjërisht në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë dhe jo më të vjetër se 6 (gjashtë) vjet në kohën e kërkesës;

d) Të kenë përmbushur shlyerjen e detyrimeve tatimore në momentin e kërkesës;

dh) Një kërkuës nuk mund të aplikojë më shumë se një herë për të njëjtën thirrje.

4. Mbështeten me grant lehtësuesit e *start up*-eve që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) Kërkuësit duhet të jenë persona fizikë ose juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë ose në gjykatë në rastin e OJF-ve;

b) Të jenë në pronësi të shtetasve shqiptarë;

c) Të kenë kryer aktivitete në ndihmë të *start up*-eve gjatë 2 (dy) viteve të fundit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të vërtetuar nëpërmjet kontratave dhe raporteve të publikuara;

ç) Të kenë përmbushur shlyerjen e detyrimeve tatimore në momentin e kërkesës;

d) Një kërkuës nuk mund të aplikojë më shumë se një herë për të njëjtën thirrje.

5. Projektet e shpallura fituese duhet të zbatohen brenda afatit kohor të përcaktuar në thirrjen publike për mbështetje, duke nisur nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së fitimit të grantit, midis përfutjesit dhe *Start Up Albania*.

6. Disbursimi i grantit për projektet e shpallura fituese bëhet deri në 3 (tri) kështe pas përfundimit të periudhës së mbylljes së çdo faze të projektit, kundrejt dorëzimit të faturës/ave të shpenzimeve të kryera dhe dokumentacionit të kërkuar, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloren “Për zbatimin dhe monitorimin e projekteve fituese të thirrjes për masa mbështetëse”.

7. *Start up*-eve dhe lehtësuesve iu lëvrohet fondi për projektin në 3 (tri) kështe:

a) Kësti i parë: 30% (tridhjetë për qind) të vlerës së fondit menjëherë pas nënshkrimit të kontratës së grantit;

b) Kësti i dytë: 40% (dyzet për qind) të vlerës së fondit menjëherë pas miratimit nga *Start Up Albania* të raportit përshkrues dhe financiar të fazës së parë;



c) Kësti i tretë: 30% (tridhjetë për qind) të vlerës së fondit pas miratimit nga *Start Up Albania* të raportit përshkrues dhe financiar përfundimtar.

III. PROCEDURAT DHE AFATET E THIRRJES

1. Në shpalljen e thirrjes evidentohen edhe forma dhe sasia e granteve financiare që parashikohen të akordohen.

2. Kërkesa për mbështetje me grant kryhet elektronikisht nëpërmjet portalit “*e-Albania*”.

3. Afati për dërgimin e kërkesave për masa mbështetëse dhe periudha e thirrjes nuk mund të jetë më pak se 10 (dhjetë) ditë kalendarike dhe jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë.

4. Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të shoqërojë kërkesën për masa mbështetëse përcaktohet në rregulloren e shpallur të thirrjes.

IV. NGRITJA E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT DHE ANKIMIT

1. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas publikimit të “Thirrjes për kërkesa për masa mbështetëse”, me urdhrë të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen ngrihet Komisioni i Vlerësimit dhe Komisioni i Ankimit, duke caktuar edhe kryetarët përkatës.

2. Komisioni i Vlerësimit ka për qëllim shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave nga *start up*-et e lehtësuesit dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të cilët janë përfaqësues nga organet e administratës shtetërore, bota akademike, ekosistemi kombëtar dhe ndërkombëtar i *start up*-eve.

3. Drejtori i *Start Up Albania* është anëtar i Komisionit të Vlerësimit për shkak të detyrës.

4. Komisioni i Ankimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të cilët janë përfaqësues nga organet e administratës shtetërore, bota akademike, ekosistemi kombëtar dhe ndërkombëtar i *start up*-eve.

5. Anëtarët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

5.1 Anëtari i Komisionit i përzgjedhur nga organet e administratës shtetërore duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Të jetë nëpunës i administratës shtetërore;

b) Të ketë pjesë të detyrave të tij funksionale hartimin, zbatimin ose monitorimin e politikave, programeve dhe projekteve për ekosistemin dhe kompanitë *start up*.

5.2 Anëtari i Komisionit i përzgjedhur nga bota akademike duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë pune përkatëse në universitete dhe/ose organizata kërkimore për fusha specifike ku përfshin kërkimin dhe zhvillimin për industrinë;

b) Të ketë përvojë menaxhimi brenda sektorit të industrisë ose përvojë në projekte kërkimore;

c) Të ketë përvojë në vlerësimin e projektpropozimeve, në kuadër të programeve kombëtare ose ndërkombëtare në përgjithësi dhe brenda fushave që u përgjigjen objektivave të thirrjes.

5.3 Anëtari i Komisionit i përzgjedhur nga ekosistemi kombëtar dhe ndërkombëtar i *start up*-eve duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë pune përkatëse në organizma kombëtarë dhe ndërkombëtarë që kanë për qëllim mbështetjen ndaj kompanive *start up* dhe lehtësuesve të ekosistemit;

b) Të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë në menaxhimin e projekteve;

c) Të ketë përvojë në bashkëpunim ndërkombëtar në zhvillim të kompanive *start up* dhe të ekosistemit;

ç) Të ketë përvojë si anëtar/kryetar i panelit të ekspertëve ose drejtor i propozimeve të programeve ose projekteve dhe anëtar/kryetar i komisionit të vlerësimit të fondeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

6. Anëtarët përzgjidhen mbi bazën e një procesi transparent, bazuar në thirrjen e hapur, të publikuar në faqen zyrtare të *Start Up Albania* dhe ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

7. *Start Up Albania* ngarkohet të hartojë termat e referencës, të përcaktojë afatin e aplikimit, të menaxhojë procesin e përzgjedhjes së anëtarëve dhe t'i propozojë për miratim ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

8. Në përfundim të procesit të konkurrimit për anëtarët, ministri përgjegjës për sipërmarrjen shpall fitues, në cilësinë e anëtarit të komisioneve, kandidatët e vlerësuar me pikët më të larta, dhe kandidatët e renditur të dytët, në cilësinë e zëvendësuesit, në rastin e krijimit të vakancës.

9. Anëtari i Komisionit të Vlerësimit dhe Komisionit të Ankimit lirohet nga detyra me urdhrë të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen në rastet e mëposhtme:

a) Ka ndërprerë marrëdhënien e punës me institucionin ose organizatën kërkimore që përfaqëson;



b) Është dënuar me vendim penal të formës së prerë;

c) Bëhet i paaftë mendërisht ose fizikisht për të ushtruar detyrën;

ç) Me veprimet e tij dëmton veprimtarinë e komisionit dhe imazhin e institucionit përgjegjës për funksionimin e këtij komisioni;

d) Nuk merr pjesë në 2 (dy) mbledhje radhazi të komisionit pa shkak të arsyeshëm dhe nuk ka njoftuar paraprakisht kryetarin.

V. VLERËSIMI I KËRKESAVE PËR MASA MBËSHTETËSE

1. Komisioni i Vlerësimit mblidhet në mbledhjen e parë, jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike pas mbylljes së thirrjes për aplikime nga *start up*-et dhe lehtësuesit e *start up*-eve.

2. Sekretariati teknik pranë *Start Up Albania* administron kërkesat së bashku me dokumentacionin shoqërues dhe i vendos në dispozicion anëtarëve praktikant dokumentare e raportin përmbledhës të aplikimeve.

3. Mbledhjet e Komisionit të Vlerësimit thirren dhe drejtohen nga kryetari i këtij Komisioni.

4. Komisioni i Vlerësimit merr në shqyrtim kërkesat për mbështetje me grant dhe në fund të procesit të vlerësimit, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike miraton me vendim listën paraprake të aplikimeve fituese.

5. Komisioni i Vlerësimit ushtron këto detyra dhe kompetenca:

a) Shqyrton e vlerëson çdo kërkesë;

b) Plotëson formularët e vlerësimit për çdo kërkesë të dorëzuar dhe anëtarët e tij japin pikët individuale;

c) Përgatit renditjen paraprake të kërkesave bazuar në pikëzimin dhe vendimarrjen e të gjithë anëtarëve dhe, sipas rastit, përgatit rekomandimet për rishikim të kërkesave me qëllim përmirësimin e tyre;

ç) Harton dhe nënshkruan procesverbalin e vlerësimit dhe listën e kërkesave të përzgjedhura për financim.

6. Kërkuesit mund të depozitojnë ankesat për shkelje të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për masë mbështetëse brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga njoftimi elektronik.

7. Komisioni i Ankimit ka për qëllim shqyrtimin e ankesave për shkelje të procedurës së shqyrtimit sipas këtij vendimi nga Komisioni i Vlerësimit.

8. Komisioni i Ankimit mblidhet në mbledhjen e parë, jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 6, të këtij kreu.

9. Sekretariati teknik i ngritur nga *Start Up Albania* i vendos në dispozicion anëtarëve të Komisionit të Ankimit praktikant dokumentare të ankimeve të mbërritura dhe raportin pasqyruar të praktikave dokumentare të depozituara.

10. Mbledhjet e Komisionit të Ankimit thirren dhe drejtohen nga kryetari i këtij Komisioni.

11. Për organizimin e mbledhjeve të Komisionit të Ankimit njoftohen anëtarët jo më pak se 2 (dy) ditë kalendarike nga organizimi dhe mbledhjet janë të vlefshme nëse marrin pjesë të paktën 2 (dy) anëtarë.

12. Në fund të vlerësimit të ankesave, Komisioni i Ankimit miraton me vendim kërkesat për t'ia kaluar për rishqyrtim Komisionit të Vlerësimit, ku parashtron edhe shkeljet procedurale në shqyrtimin e kërkesës për mbështetje nga Komisioni i Vlerësimit.

13. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga marrja e vendimit nga Komisioni i Ankimit, Komisioni i Vlerësimit merr në shqyrtim të dytë aplikimet e atyre kërkuesve, ankesa e të cilëve është pranuar nga Komisioni i Ankimit.

14. Pas shqyrtimit të dytë të aplikimeve, Komisioni i Vlerësimit merr vendimin për listën përfundimtare të fituesve, i cili i përcillet për miratim ministrit përgjegjës për sipërmarrjen. Urdhri i miratimit publikohet në faqen zyrtare të *Start Up Albania*, të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

15. *Start Up Albania* dhe subjekti përfitues nënshkruajnë kontratën e grantit, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga miratimi i listës së përfituesve nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen.

16. Në kontratën e grantit përcaktohen rregullat, afatet e përgjegjësitë e palëve për realizimin e projektit, dokumentacioni dhe afatet për raportimin përshkruar e financiar, mënyra e transferimit të fondeve, shpenzimet e njohura e të pranueshme, mekanizmat e raportimit e të kontrollit, përfshirë detyrimin e subjektit përfitues për të vënë në dispozicion të Kontrollit të Lartë të Shtetit dokumentacionin për veprimtarinë financiare të kryer, mënyra e dokumentimit të shpenzimeve të kryera dhe të produkteve e aktiviteteve të realizuara.



17. *Start Up Albania* kryen lëvrimin e fondit sipas parashikimeve të kontratës së nënshkruar me fituesit e granteve.

VI. KRITERET VLERËSUESE

1. Kërkesat shqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit, ku secili nga anëtarët i vlerëson ato mbi bazën e pikëzimeve të caktuara në formularët e pikëzimit, të miratuar në rregulloren “Për zbatimin dhe monitorimin e projekteve fituese të thirrjes për masa mbështetëse”, të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

2. Fituesit shpallen sipas renditjes së pikëve të mbledhura në raport me fondin total në dispozicion.

VII. MASA E SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONEVE

1. Shpërblimi i kryetarëve dhe anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit dhe të Komisionit të Ankimit është në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për mbledhje, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) pagesa në vit.

2. Shpenzimet për shpërblimin e kryetarëve e të anëtarëve vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje dhe mbulohen nga buxheti i miratuar i *Start Up Albania*.

VIII. RAPORTIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I GRANTEVE

1. Subjekti përfitues raporton pranë *Start Up Albania* për ecurinë e zbatimit të grantit, bazuar në kushtet dhe afatet e përcaktuara në kontratën e grantit, udhëzuesin për raportimin periodik të progresit dhe dokumentet mbështetëse të raportimit, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen.

2. *Start Up Albania* kryen monitorimin e zbatimit të projekteve dhe raporton për mbarëvajtjen e tyre pranë ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

3. *Start Up Albania* kryen çdo vit vlerësimin e performancës së fondit grant, që përfshin vlerësimin e menaxhimit të thirrjes nga *Start Up Albania*, si dhe rezultatet e ndikimit të arritur nga kërkesat e financuara. Vlerësimi kryhet brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i zbatimit të kërkesave të mbështetura në një program vjetor financimi dhe përmban, të paktën, elementet e mëposhtme:

a) Informacionin për thirrjet publike të zbatuara, sasinë e fondeve të shpërndara dhe shpenzimet e realizuara;

b) Informacionin për numrin e aplikimeve të thirrjes dhe përshkrimin e cilësive dhe të të metave të kërkesave të kandidatëve;

c) Informacion për arritjet e ndikimin e projekteve të mbështetura dhe kontributin e tyre për realizimin e objektivave të shpallur të thirrjes publike;

ç) Të dhëna për numrin e ankimeve administrative të paraqitura dhe për vendimet përfundimtare të shqyrtimit të tyre.

IX. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Funksionimi i Komisionit të Vlerësimit dhe i Komisionit të Ankimit i nënshtrohet rregullave të parashikuara në legjislacionin për organet kolegjiale të administratës shtetërore për çështjet që nuk janë të rregulluara posaçërisht në këtë vendim dhe në urdhrin për ngritjen e tyre nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen.

2. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 313, datë 11.5.2022, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të kriterëve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij”, dhe nr. 315, datë 11.5.2022, “Për përcaktimin e kërkesave dhe kriterëve që duhet të plotësojnë *start up*-et dhe lehtësuesit e *start up*-eve, si dhe miratimin e procedurave dhe afateve të thirrjes për përfitimin e granteve dhe masave mbështetëse”, shfuqizohen.

3. Ngarkohen ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Start Up*-eve dhe Lehtësuesve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 1, datë 1.2.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES TEKNIKE MBI STANDARDET PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SUBJEKTET QË SHKARKOJNË UJËRA TË NDOTURA DHE TË PATRAJTUARA PRANË OSE NË UJËRA LARËSE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të aktit normativ nr. 8, datë 28.12.2023, “Për marrjen e masave urgjente, për mbrojtjen dhe përmirësimin e



infrastrukturës, për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse”,

UDHËZOJMË:

1. Miratimin e rregullore teknike për standardet për trajtimin e ujërave të ndotura për subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotura dhe të patrajuara pranë ose në ujëra larëse, sipas tekstit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, Task-Forca dhe subjektet që do të monitorohen sipas aktit normativ nr. 8, datë 28.12.2023, “Për marrjen e masave urgjente, për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës, për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro (Furxhi)

RREGULLORE TEKNIKE MBI STANDARDET PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SUBJEKTET QË SHKARKOJNË UJËRA TË NDOTURA TË PATRAJTUARA PRANË OSE NË UJËRA LARËSE

KREU I
HYRJE

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. Kjo rregullore del në zbatim të pikës 2, të nenit 5, të aktit normativ nr. 8, datë 28.12.2023, “Për marrjen e masave urgjente për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse” (në vijim akti normativ nr. 8, datë 28.12.2023).

2. Subjektet, të cilat kryejnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare, turistike, bregun e

liqeneve, të lumenjve dhe shkarkojnë ujëra të ndotura të krijuara nga aktiviteti i tyre, do të monitorohen dhe inspektohen për zbatimin e standardeve parashikuar në këtë rregullore teknike.

3. Monitorimi dhe inspektimi i zbatueshmerisë së standardeve parashikuar në këtë rregullore teknike bëhet nga Task-Forca, e krijuar në varësi të titullarit të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK).

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë standardet për trajtimin e ujërave të ndotura të patrajuara për të gjitha subjektet sipas përcaktimeve të aktit normativ nr. 8, datë 28.12.2023.

Neni 3
Termet e përdorur

Termet e përdorur kanë të njëjtin kuptim si ata të përdorur në nenin 2, të aktit normativ nr. 8, datë 28.12.2023.

KREU II
BAZA LIGJORE

Neni 4
Kuadri ekzistues rregullator

1. Kjo rregullore është hartuar në përputhje me:

a) ligjin nr. 9115, datë 24.7.2003, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, i ndryshuar;

b) ligjin nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar;

c) vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 31.3.2005, “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”;

d) vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 10.2.2021, “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe të ndërtimit për furnizimin me ujë dhe kanalizimin”;

e) direktivën e Bashkimit Evropian për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/EEC);

f) direktivën e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 15.2.2006, lidhur me menaxhimin e cilësisë së ujërave larëse;



g) direktivën 86/278/KEE “Për llumin e ujërave të ndotura”;

h) vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 448, datë 26.7.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023–2030”.

KREU III ZBATUESHMËRIA TEKNIKE

Neni 5 Subjektet që do të monitorohen

Subjektet të cilat janë të përcaktuara në nenin 2, të aktit normativ nr. 8, datë 28.12.2023, do të monitorohen për mënyrën dhe standardet e përcaktuara në këtë rregullore teknike.

Neni 6 Kategorizimi i subjekteve

Subjektet që ushtrojnë veprimtari ekzistuese, janë në proces ndërtimi ose kanë aplikuar për leje ndërtimi, në bazë të kapacitetit dhe zgjidhjeve teknike ekzistuese apo që janë planifikuar për t’u zbatuar, të lidhura ose jo me rrjetin publik të kanalizimeve, duhet të instalojnë impiante të trajtimit të ujërave të ndotura sipas përcaktimeve të kategorive shprehur në nenin 2, të aktit normativ nr. 8, datë 28.12.2023.

Neni 7 Përcaktimi i vlerave të lejuara të shkarkimeve nga trajtimi i ujërave të ndotura

1. Vlerat e lejuara të shkarkimeve nga trajtimi i ujërave të ndotura, detyrim i subjekteve për të përmbushur janë përcaktuar në aneksin nr. 2 të kësaj rregullore teknike.

2. Parametrat e kërkuar në pikat 4 dhe 5, të aneksit nr. 2 aplikohen nga të gjitha subjektet, pjesë e aktit normativ, që zhvillojnë veprimtari ekonomike pranë zonave të ndjeshme të listuara në aneksin nr. 4.

3. Subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas pikave 1 deri 12, të nenit 2, të aktit normativ nr. 8, datë 28.12.2023, duhet të trajtojnë ujërat e ndotura të krijuara nga aktiviteti i tyre në përputhje me vlerat e lejuara të shkarkimeve nga trajtimi i

ujërave të ndotura dhe afateve të përcaktuara në aktin normativ.

Neni 8 Teknologjia për trajtimin e ujërave të ndotura

1. Teknologjia e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura duhet të jetë ajo e trajtimit me llum aktiv.

2. Të gjitha subjektet që disponojnë gropa septike duhet t’i zëvendësojnë me impante të trajtimit me llum aktiv dhe të plotësojnë standardet mbi vlerat e lejuara të shkarkimeve sipas përcaktimeve në aneksin nr. 2 të kësaj rregullore teknike.

Neni 9 Sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura

1. Sistemi i kanalizimeve të brendshme brenda ndërtesave dhe të rrjetit të oborrit brenda territorit të subjekteve deri në pikën e lidhjes me impiantin duhet të projektohet dhe ndërtohet sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 10.2.2021, “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe të ndërtimit për furnizimin me ujë dhe kanalizimin”.

2. Pika e lidhjes ndërmjet rrjetit të brendshëm të kanalizimeve të ujërave të ndotura me Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura duhet të realizohet pas pusëtës së kontrollit, e cila është përcaktuar në VKM-në nr. 83, datë 10.2.2021.

3. Lidhja e pusëtës së kontrollit me hyrjen në impiant duhet të jetë sipas kushteve dhe standardeve teknike në fuqi dhe duhet të realizohet me tubacion në varësi të kapaciteteve të impiantit që duhet të instalohe sipas përcaktimeve në nenin 10.

4. Impianti është njësi teknologjike që bën trajtimin e ujërave të ndotura të patrajtuara që duhet të projektohet dhe realizohet sipas përcaktimeve të nenit 11 të kësaj rregulloreje teknike.

5. Shkarkimi i ujërave të trajtuara nga impianti do të depozitohet në një pusetë kontrolli, e cila do të realizohet me përmasat e përpunimit të impiantit.

6. Kjo pusetë duhet të përdoret për marrjen e kampioneve për testet e cilësisë së ujit e cila do të konsiderohet pjesë përbërëse e impiantit.



Neni 10

Llogaritja e kapacitetit të Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura

1. Kapaciteti i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura do të përcaktohet sipas madhësisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet ekonomik sipas përkufizimeve të nenit 2, të aktit normativ nr. 8, datë 28.12.2023, si dhe kapacitetit të shfrytëzimit.

2. Kapaciteti mesatar i shfrytëzimit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet ekonomik për njësi dhe dhomë është përcaktuar 3 persona.

3. Kapaciteti i shfrytëzimit për njësi shërbimi është përcaktuar 1.75 m²/person.

4. Sasia e ujërave të ndotura të shkarkuara nga çdo person do të merret 100% e sasisë së ujit të konsumuar, sipas metodologjisë për vendosjen e tarifave të Entit Rregullator të Ujit.

5. Sasia e ujit të konsumuar për çdo person do të merret 200 litra/person/ditë, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 10.2.2021, “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit e të ndërtimit për furnizimin me ujë dhe kanalizimin”.

6. Për njësitë e shërbimit, sasia e ujit të konsumuar do të merret 40 litra/person/ditë bazuar në standardet më të mira evropiane.

7. Kapaciteti i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura përcaktohet në bazë të ngarkesës së ndotjes që trajton dhe shprehet në PE ose “NJP, njëvlerës për popullsinë”. 1 PE = 200 litra ujë i ndotur urban në ditë ose 1 PE = 1 person.

Për njësitë e shërbimit përcaktimi i kapacitetit llogaritet si raport i sasisë së ujit të konsumuar për person/ditë me sasinë e përcaktuar për ujin e ndotur urban për 1 PE. Konkretisht, 1 person = 0.2 PE.

Neni 11

Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura

1. Impianti duhet të përfshijë:

- a) njësinë e paratrajtimit ose trajtimit mekanik;
- b) njësinë e trajtimit biologjik;
- c) pusëtën e kontrollit në dalje të impiantit.

2. Njësia e paratrajtimit ose trajtimit mekanik, duhet të pranojë të gjithë prurjen e ujërave të ndotura të patrajtuar dhe identifikohet si njësia e sedimentimit që shërben në të njëjtën kohë edhe si depozitë e llumit të tepërt. Kjo njësi nëpërmjet dekantimit redukton kryesisht masën e ngurtë të ujërave të ndotura dhe, rrjedhimisht, redukton

pjesërisht nivelin e ndotjes duke përmirësuar cilësinë për një pjesë të vlerave të lejuara të shkarkimeve sipas aneksit nr. 1 të kësaj rregulloreje teknike. Masa e ngurtë në formë llumi e dekantuar në fundin e depozitës i nënshtrohet dekompozimit nëpërmjet procesit anaerobik (fermentimit) pa prezencë aktive të oksigjenit. Pjesa e padekantuar, e paratrajtuar e prurjes kalon transit te njësia e trajtimit biologjik.

3. Njësia e trajtimit biologjik, përgjithësisht nëpërmjet mënyrës klasike të trajtimit me llum aktiv trajtohen ujërat e ndotura duke reduktuar ndotjen organike në nivelet e pranueshme sipas legjislacionit. Te kjo njësi ndodhin të gjitha proceset e pastrimit të ujit, si: ajrimi, sedimentimi i llumit aktiv, ndarja e ujit të pastër të trajtuar, si dhe shkarkimi i ujit të trajtuar dhe largimi i llumit të tepërt.

4. Pusëta e kontrollit në dalje të impiantit, shërben jo vetëm si pusëtë kontrolli gjatë operimit të sistemit, por edhe si depozitë për grumbullimin e ujit të trajtuar.

5. Kur uji i trajtuar do të shkarkohet në rrjetin publik të ujërave të ndotura urbane do të lidhet nëpërmjet linjës së dërgimit te kolektori ose rrjeti më i afërt.

6. Në mungesë të rrjetit publik të ujërave të ndotura urbane, kur uji i trajtuar nuk do të shkarkohet në rrjet apo nuk do të ripërdoret për vaditje, dimensionimi i pusëtës së kontrollit duhet të bëhet i tillë që të merret në konsideratë një kohë/periudhë pritje për depozitim të ujit të trajtuar prej 5 deri në 7 ditë.

Kjo kohë është e nevojshme për të bërë të mundur evadimin e këtyre ujërave nëpërmjet mjeteve thithëse teknologjike specifike për të përshtatshme për këtë shërbim.

7. Sasia e ujit të trajtuar të depozituar duhet të largohet nëpërmjet mjeteve thithëse në kolektorin apo impiantin më të afërt të trajtimit të ujërave të ndotura nëpërmjet operatorëve privatë apo shtetërore të licencuar që e ofrojnë këtë shërbim sipas legjislacionit mjedisor në fuqi.

8. Skema tip e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura është përcaktuar në aneksin nr. 5 të kësaj rregulloreje teknike.

Neni 12

Ripërdorimi i ujit të trajtuar

Ripërdorimi i ujit të trajtuar mund të përdoret për vaditje të ambienteve të gjelbra të komplekseve ose



pastrim të territoreve përreth, kur vlerat e lejuara të shkarkimeve të ujërave të ndotura janë në përputhje me përcaktimet e shprehura në aneksin nr. 1 të kësaj rregulloreje teknike.

Neni 13

Kushtet teknike të instalimit të Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura

1. Procesi i instalimit të impiantit bëhet si më poshtë:

a) impiantet duhet të prodhohen me material PVC-U, polietilen (PE), polipropilen (PP) dhe poliestër i përforcuar me fibra qelqi (GRP-UP);

b) sistemi i trajtimit të ujërave të ndotura duhet të instalohet nëntokë duke ndjekur udhëzimet e prodhuesit;

c) paraprakisht duhet të kryhen gjërmimet për hapjen e gropës në përmasa të përshtatshme për të bërë të mundur instalimin e impiantit. Pjesa fundore e gropës do të mbushet me një shtresë rëre me trashësi 10 cm me madhësi të kokrrës 0–5 mm. Kjo shtresë duhet të nivelohet, në mënyrë që të bëjë të mundur gjithashtu vendosjen e impiantit në nivelin e kërkuar sipas projektit teknik. Gjithashtu, në varësi të peshës totale të impiantit, shtresa e rërës duhet zëvendësuar me shtresë betoni C 12/15 me trashësi minimale prej 10 cm;

ç) njësia e trajtimit biologjik duhet të lidhet me pusëtën e kontrollit me tubacion PVC me diametër sipas përcaktimeve të projektit teknik;

d) njësia e trajtimit biologjik duhet të lidhet me njësinë e paratrajtimit me tubacion PVC me diametër sipas përcaktimeve të projektit teknik;

dh) në rastet kur në instalimet e brendshme të godinës nuk ka kolonë ajrimi të tualeteve atëherë në pjesën e sipërme duhet të instalohet tubacion ajrimi me diametër 100 mm;

e) pas instalimit hapësirat midis gropës dhe impiantit duhet të mbushen me rërë me madhësi të kokrrës 0–5 mm;

ë) pjesa e sipërme duhet të përfundojë në formë solete me një shtresë betoni C 12/15 me trashësi 10 cm, ose, nëse zona do t'i nënshtrohet trafikut të mjeteve duhet të përfundojë me një shtresë betoni C 20–25 të armuar me trashësi 25 cm;

f) në përputhje me instruksionet e prodhuesit, procesi i ajrimit duhet të fillojë duke lidhur kompresorin me sistemin e furnizimit me energji 220 volt;

g) për të stimuluar dhe filluar sa më shpejt procesin e trajtimit biologjik në njësinë e trajtimit biologjik mund të futen baktere të ruajtura në kushte laboratorike;

gj) gjatë instalimit të impiantit duhet kushtuar vëmendje që në zonën e sedimentimit mos të ketë zona të izoluar ku llumi mund të qëndrojë në gjendje stanjacioni pasi mund të bëhen shkak për aktivitet të proceseve anaerobike.

2. Procesi i gjërmimit bëhet si më poshtë:

a) gjërmimi do të kryhet duke zbatuar kushtet teknike të zbatimit në ndërtim me mjete gjërmimi në varësi të kategorisë së tokës. Sipërfaqja e gjërmimit duhet të respektojë përmasat e impiantit në tërësi dhe çdo njësi në veçanti duke respektuar në çdo rast distancën minimale nga faqet vertikale të impiantit prej 100 cm në rastin kur kategoria e tokës dhe thellësia e projektit sipas kushteve teknike lejon gjërmime me skarpate vertikale;

b) thellësia e gjërmimit duhet të jetë e tillë që të krijohet shtresa niveluese midis nivelit të gjërmuar dhe pjesës së jashtme të tabanit të impiantit me lartësi minimale prej 10 cm. Materiali mbushës i shtresës niveluese duhet të jetë rërë natyrale me përmasa 0–5 mm ose shtresë betoni C 12/15 me trashësi 10 cm;

c) pjerrësia e skarpateve në gjërmim duhet të ndjekë kushtet teknike të zbatimit sipas kategorisë së tokës, duke respektuar në çdo rast distancën minimale nga faqet e jashtme vertikale të impiantit prej 100 cm;

ç) panelet mbrojtëse (palankula) gjatë gjërmimit:

Subjekti duhet të sigurojë furnizimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e të gjitha materialeve të nevojshme, për të mbrojtur anët dhe shtratin e të gjitha seksioneve të gjërmuara, për të parandaluar çdo shembje të dheut jashtë gjërmimit dhe dëmtimin e strukturave ngjitur me gjërmimin. Nëse, për ndonjë arsye, ndonjë pjesë e shtratit, anëve ose skajeve të kanalit do të dëmtohen, duhet të merren të gjitha masat e nevojshme korrigjuese, duke përfshirë gjërmimin dhe heqjen e të gjithë materialit të gjërmuar brenda dhe jashtë kufijve nominalë të gjërmimeve;

i. kur propozohet të kryhen gjërmime me faqe të pjerrëta (përveç gjërmimeve me faqe të pjerrëta të paraqitura në vizatime standarde) dhe pa panele mbrojtëse, faqet e gjërmuara duhet të jenë në pjerrësi dhe lartësi të qëndrueshme;

ii. kur toka ku do të gjërmohet ka pendencë drejt shtratit të tij, duhet të sigurohet mbrojtja e duhur



menjëherë pas gërmimit. Kujdes i veçantë duhet të tregohet me tokën, e cila, edhe pse e fortë kur gërmohet, mund të bëhet e paqëndrueshme nga shiu ose rrjedhja e ujërave nëntokësore. Nëse gjerësia e seksionit të gërmimit rritet në mënyrë të pashmangshme nga rrëshqitja ose shembja e faqeve të kanalit, puna duhet të pezullohet, në mënyrë që projektimi i njësive të mund të rishikohet në raport me gjerësinë e shtratit të seksionit të gërmuar dhe nëse është e nevojshme të ndryshohet klasa e materialit mbushës së shtratit të seksionit të gërmuar;

iii. kostot për mbrojtjen e seksionit të gërmuar do të mbulohen plotësisht nga investitori;

d) mbrojtja e seksionit të gërmuar do të përdoret në varësi të thellësisë së tij dhe vetive të materialit të gërmimit;

i. thellësia $<1.25\text{m}$: në përgjithësi, nuk duhet të përdoret asnjë mbrojtëse, përveç në rastet e dherave shumë të shkrifëta, ranore ose dhera të shkrifëta. Në rastet e dherave shumë të shkrifëta, në vend të paneleve mbrojtëse, faqet e seksionit të gërmuar mund të realizohen në një pjerrësi 45 gradë;

ii. $1.25\text{m} < \text{thellësi} < 1.5\text{m}$: në rast se Kontraktori dëshiron të mos përdorë panele mbrojtëse në një seksion, ai duhet të paraqesë një raport gjeoteknik/gjeologjik të materialit të gërmimit në atë seksion duke e justifikuar këtë;

iii. $1.5\text{ m} < \text{thellësi}$: do të përdoren panele mbrojtëse përveç rasteve kur toka që do të gërmohet është shkëmb i fortë;

iv. aty ku do të realizohet gërmim me makineri, 10 cm i fundit të kanalit duhet të gërmohet manualisht;

v. hapësira e gërmuar në thellësinë e specifikuar duhet të nivelohet. Përpara vendosjes së njësive të impiantit, rëra e shtratit të seksionit të gërmuar ose materiali i importuar duhet të mbushet në një nivel minimal prej 10 cm;

dh) skarifikimi (nivelimi) dhe shtresat e betonit;

i. të gjitha sipërfaqet e themlit duhet të nivelohen, profilizohen dhe ngjishen ose me materiale të përshtatshme ose me beton në mënyrë të tillë që kryerja e mëtejshme e punimeve të mos ndikojë në tabanin e njësive të impiantit. Nëse nuk përmendet ndryshe në këtë dokument, të gjitha sipërfaqet e themlit duhet të mbrohen me një shtresë betoni C 12/15 me trashësi minimale 10 cm menjëherë pas përfundimit të gërmimit.

3. Procesi i mbushjes bëhet si më poshtë:

a) mbushja e hapësirës midis vëllimit të gërmuar dhe vëllimit që okupon impianti dhe njësitë e tij do

të kryhen me rërë me përmasa 0–5 mm. Në rastet e tubacioneve lidhëse midis njësive mbushja do të kryhet me rërë me përmasa 0–5 mm, duke respektuar shtresat prej 20 cm poshtë, anësore dhe mbi tub. Pjesa tjetër mbi rërë duhet të mbushet me material inert me përmasa 0/32 mm;

b) të gjitha seksionet e gërmuara duhet të mbushen në nivelin e sipërfaqes fillestare të tokës, përveç rasteve kur tregohet ndryshe në vizatime. Thellësia e mbetur mbi mbushjen do të rimbushet me material të selektuar të miratuar pa gurë dhe grimca organike. Materiali i importuar zhavorri 0/32, 0/63 etj., duhet të ketë një kurbë sitë që shtrihet midis kufijve të miratuar. Materiali mbushës nga gërmimi mund të përdoret nëse plotëson kërkesat dhe ngjishet në shtresa 20 cm. Në rastin kur pjesë të seksionit të gërmuar janë në rrugë, mbushja përfundon 60 cm poshtë shtresës së sipërme përfundimtare;

c) në rastet kur seksionet e gërmuara janë në rrugë asfalti duhet të mbushen me material të përzgjedhur të vendosur dhe duhet të ngjishen në shtresa jo më shumë se 20 cm në trashësi, të lagen deri në përmbajtjen optimale të lagështisë dhe të ngjishen në një densitet jo më të vogël se 90 për qind të densitetit maksimal të thatë në përmbajtjen optimale të lagështisë ose materialit përreth;

ç) mbushja e seksioneve të gërmuara deri në sipërfaqe;

i. nga shtresa e sipërme e rërës deri në nivelin e tokës, kanali duhet të mbushet me material të përzgjedhur të miratuar, të ngjeshur me metoda mekanike të miratuara në shtresa me trashësi jo më shumë se 150 mm;

ii. çdo shtresë duhet të ngjishet veç e veç. Shkalla e ngjeshjes nuk duhet të jetë më pak se 95% se dendësia maksimale në gjendje të thatë. Duhet të sigurohet numri i mjaftueshëm i pajisjeve ngjeshëse;

iii. kur është e nevojshme, duhet të rregullojë përmbajtjen e lagështisë së materialit të rimbushjes për të ndihmuar ngjeshjen ose duke tharë ose duke spërkatur me ujë. Një sasi e nevojshme uji duhet të jetë në dispozicion në terren gjatë mbushjes së kanaleve;

iv. kur vendoset mbushja, duhet të parashikohet për çdo ulje që mund të ndodhë përpara fazës së përfundimit të periudhës së mirëmbajtjes. Kur është e nevojshme, në fund të periudhës së mirëmbajtjes duhet të hiqet çdo material i tepërt ose do të plotësohet çdo mangësi e mbushjes në nivele të specifikuara;



v. në rast se materiali i gërmuar është i pamjaftueshëm ose i papërshtatshëm për mbushje, duhet të përdoren materiale mbushëse të importuara nga karriera guri të miratuara. Në rastet e instraktuara gërmimet e seksioneve do të mbushen me beton të klasës C 12/15.

4. Procesi i rikthimit të sipërfaqeve në gjendjen e mëparshme:

a) pasi të jenë rimbushur seksionet e gërmuara në nivelin e specifikuar, ai do të zëvendësojë të gjithë sipërfaqen e tokës së hequr më parë dhe ajo do të shpërndahet dhe nivelohet në mënyrë të barabartë në të gjithë shtrirjen e zonës së gërmuar;

b) sipërfaqet të cilat përpara gërmimeve ishin të mbuluara me bar pas mbushjes do të mbillen me farë bari të cilësisë së njëjtë dhe do të mirëmbahen derisa bari i ri të vendoset siç duhet.

5. Procesi i rikthimit të sipërfaqeve në gjendjen e mëparshme në rrugë asfalti:

a) rikthimi në gjendjen e mëparshme në rrugët e asfaltuara duhet të jetë në përputhje me kërkesat e autoritetit menaxhues rrugor përkatës. Shtresa e sipërme e rivendosjes së sipërfaqes në rrugët e asfaltit duhet të jetë e shtruar mirë dhe e përfunduar në nivel me sipërfaqet ekzistuese dhe duhet të ruhet në këtë mënyrë (duke përfshirë mbushjen me material shtesë kur është e nevojshme) deri në fund të periudhës së mirëmbajtjes ose derisa të merret në dorëzim nga autoriteti përkatës;

b) rrugët me zhavorr dhe rrugët e paasfaltuara do të rikthehen në gjendjen e tyre fillestare. Nëse ndërtimi original i rrugës nuk mund të zbatohet qartë, atëherë do të sigurohet zhavorr i madh i miratuar 100 mm dhe material zhavorri i klasifikuar mirë 150 mm i ngjeshur në 95% të densitetit maksimal në korrespondencë me testimin në (DIN 18127, 2012-09).

Neni 14

Menaxhimi i llumit që gjenerohet nga trajtimi i ujërave

1. Inkurajohet ripërdorimi i llumit, në mënyrë që të reduktohen efektet negative që rrjedhin nga dërgimi në pikat e autorizuara. Llum i përmban substanca organike dhe lëndë ushqyese dhe përdorimi në bujqësi kontribuon në pjellorinë e tokës duke reduktuar përdorimin e plehrave kimike dhe fosile.

2. Subjektet, prodhues të llumit, duhet të reduktojnë prodhimin specifik të llumit dhe të përmirësojnë cilësinë e llumit të prodhuar duke nxitur përdorimin e tij bujqësor aty ku është e mundur. Përdorimi në bujqësi bëhet vetëm pasi të jenë kryer analizat dhe llumi të jetë brenda normave të lejuara për përdorim në bujqësi sipas VKM-së nr. 127/2015.

3. Prodhuesi i llumit duhet të disponojë një kontratë me operatorë privatë apo shtetërorë të licencuar që e ofrojnë këtë shërbim sipas legjislacionit mjedisor në fuqi, për transportimin e llumit në impiantin më të afërt. Pjesë e kontratës duhet të jetë edhe kontrata e posaçme që subjekti evadues lidh me subjektin pritës i licencuar për këtë aktivitet.

4. Grafiku i parashikuar i shkarkimeve dhe volumeve duhet të jetë i disponueshëm kurdoherë për inspektim.

5. Në rastet kur prodhuesi i llumit plotëson kushtet për të bërë trajtimin e llumit me tharje nëpërmjet mekanizmave teknologjikë të përshtatshme për sistemin e impiantit që ai disponon, ai duhet të sigurojë dhe dëshmojë që masa e thatë e prodhuar është asgjësuar në formën finale të saj.

6. Në rast evidentimi të mangësive apo problematikave lidhur me kontratat e lidhura me subjektet, sipas pikës 3 më sipër, Task-Forca njofton institucionet përgjegjëse.

Neni 15

Monitorimi

1. Procesi i monitorimit përfshin kryesisht monitorimin e shkarkimeve të lëngshme që dalin nga Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura dhe duhet të përfshijë mbledhjen e rregullt të analizave të mostrave pas trajtimit të ujërave të ndotura në impiant si përcaktohen në aneksin 3 të kësaj rregulloreje.

2. Subjektet janë të detyruara të krijojnë regjistrin e monitorimit të analizave që është subjekt kontrolli nga Task-Forca.

3. Ky regjistër mund t'u vihet në dispozicion institucioneve të interesuara, sipas kërkesës.

4. Këta mostra testohen në mënyrë rigorozë për një seri ndotësish, duke siguruar mosdevijimin nga standardet e cilësisë.



ANEKS NR. 1
SUBJEKTET SIPAS KATEGORIZIMIT

Tipologjia e subjektit	Kapaciteti	Kategoria	Sqarime
1. Fshat turistik tradicional, kompleks turistik, resort, strukturë akomoduese	10 deri 60 njësi 60 deri 100 njësi 100 deri 500 njësi 500 njësi dhe më tepër	D C B A	
2. Bujtinë, fjetinë, fjetje dhe mëngjes (B&B), hotel, motel	Më pak se 60 dhoma 60 deri 200 dhoma 200 dhoma dhe më tepër	C B A	
3. Argotizëm, kamping, njësi shërbimi	Më pak se 100 m ² Nga 100 m ² deri në 250 m ² Nga 250 m ² deri në 500 m ² Nga 500 m ² deri në 2,500 m ² 2,500 m ² dhe më tepër	E D C B A	Për njësitë e shërbimit duhet të referohet salla e ngrënies

ANEKS NR. 2
VLERAT E LEJUARA TË SHKARKIMEVE SIPAS KATEGORIVE

Parametrat	Njësia	Kategoritë ose vlerat e lejuara maksimale				
		A	B	C	D	E
1. Nevoja biokimike për oksigjen NBO ₅	mg/l	20	30	40	50	200
2. Nevoja kimike për oksigjen NKO	mg/l	50	50	100	100	400
3. Lënda e ngurtë pezull	mg/l	30	40	50	50	60
4. Fosfori total	mg/l	2.0	2.0	2.0	2.0	
5. Azoti total	mg/l	10	10	15	15	
6. Yndyrna të ngurta, pjesërisht të ngurta dhe të lëngshme (vajra)	mg/l	20	20	20	20	100
7. Intestinal enterococci (cfu/100 ml)		200*	200*	200*	200*	200*
		100**	100**	100**	100**	100**
8. Escherichia coli (cfu/100 ml)		500*	500*	500*	500*	500*
		250**	250**	250**	250**	250**

(*) Parametrat kërkohen për ujëra të mbyllura.

(**) Parametrat kërkohen për ujëra bregdetare dhe të ndërmjetme.

Parametrat e kërkuar te pikat 4 dhe 5 do të aplikohen vetëm në rastet kur ujërat e trajtuara shkarkojnë direkt në ujërat larëse, pjesë e zonave të ndjeshme të përcaktuara në aneksin 3.

Parametrat e kërkuar te pikat 7 dhe 8 do të aplikohen vetëm në rastet kur ujërat e trajtuara shkarkojnë direkt në ujërat larëse nëpërmjet kolektorit individual të subjektit.

ANEKS NR. 3
NUMRI MINIMAL I MOSTRAVE DHE FREKUENCA E MBLEDHJES SË TYRE

Kapaciteti i impiantit	Kërkesa e përcaktuar për marrjen e mostrave
Deri në 50 PE	4 mostra, ku të paktën 2 prej tyre merren gjatë sezonit veror
Deri në 180 PE	4 mostra, ku të paktën 2 prej tyre merren gjatë sezonit veror
Deri në 300 PE	4 mostra, ku të paktën 2 prej tyre merren gjatë sezonit veror
Deri në 560 PE	4 mostra, ku të paktën 2 prej tyre merren gjatë sezonit veror

Subjektet janë të detyruara të krijojnë regjistrin e monitorimit të analizave që është subjekt kontrolli nga Task-Forca. Frekuenca e marrjes së mostrave nga subjektet është e përcaktuar si në tabelën më sipër e detyrueshme për t'u zbatuar.




Task-Forca, pavarësisht sa është parashikuar më sipër, ushtron kontrole të cilësisë së ujit të trajtuar nëpërmjet marrjes së pavarur të mostrave sipas nevojave.

ANEKS NR. 4
LISTA E ZONAVE TË NDJESHME

Emërtimi i zonës së ndjeshme	Emërtimi i basenit lumor	Numri i zonave të banuara të vendndodhura mbi zonën e ndjeshme
01 Liqeni i Fierzës	Drin	8
02 Liqeni i Komanit	Drin	1
03 Kune Vain Tale Veri	Drin	5
04 Liqeni i Shkodrës	Drin	2
05 Grykëderdhja e lumit Buna/ laguna e Vilunit	Buna	6
06 Liqeni i Ohrit	Drin	4
07 Liqeni i Madh i Prespës	Drin	1
08 Liqeni i Vogël i Prespës	Drin	0
09 Liqeni i Ulzës	Mat	1
10 Kune Vain Tale Jug	Mat	2
11 Patok	Mat	5
11 Patok	Ishëm	6
11 Patok	Erzeni	1
12 Bisht Kamzë Rrushkull	Erzeni	10
13 Laguna e Karavastasë	Shkumbin	10
13 Laguna e Karavastasë	Seman	29
14 Liqenet e Belshit	Shkumbin	1
15 Liqeni i Banjës	Seman	1
16 Lumi i Vjosës dhe laguna e Nartës	Vjosa	13
17 Laguna e Orikumit	Vjosa	3
18 Liqeni i Butrintit	Vjosa	2
Totali		111

Shënim. Burimi i informacionit projekti “Planifikimi i sektorit të ujit për negociatat me Bashkimin Evropian” financuar nga qeveria suedeze.

ANEKS NR. 5
SKEMA TIP E IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA



KËRKESË

Nr. 57/17, datë 13.2.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall për disa shtesa në VKM-në nr. 332, datë 31.5.2023, “Për shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i aksit “Thumanë–Vorë–Kashar”’, i ndryshuar.

Subjekti kërkues i këtij projekti është shoqëria “G2 Infra” sh.p.k.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “arë+truall” sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa vlerësimi i pasurisë së llojit “ndërtesë” është llogaritur bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të

përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi ose jobanimi”, i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehën nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në shoqërinë “G2 Infra” sh.p.k., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 866,853,943.53 (tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e tre pikë pesëdhjetë e tre) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA PARAPRAKE

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 332, DATË 31.5.2023, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘NDËRTIMI I AKSIT RRUGORË ‘THUMANË-VORË-KASHAR’”

[illegible]

Page | 2736

[illegible]

Page | 2737

[illegible]

[illegible]

Page | 2739

[illegible]

Page | 2740

[illegible]

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë